**PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT**

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar: Projektligji Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë
2. Audienca e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

| **Audienca e synuar** (*p.sh. dhomat e tregëtisë, OJQ-të për të rinjtë, etj.*) | **Lloji i konsultimeve:** **(1) konsultime paraprake,** **(2) konsultime për projekt-ligjet** | **Metodat e konsultimit** *(e-konsultimi, takimet publike,seminare,sondazhe etj.)* | Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (*email, rrjetet sociale, etj.)* |
|---|---|---|---|
| *Institucionet Shtetërore* | *Konsultime paraprake për strukturën dhe çështjet kryesore që do të përmbajë projektligji* | *Takime online dhe* konsultime nëpërmjet komunikimit me email | *Email zyrtar* |
| *Organizata të Shoqërisë Civile në fushën e mbrojtjes së fëmijëve* | Konsultimi publik, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale* | *Takime fizike në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale* | |
| | | *Vlerësimi nga konsultimi publik i mbyllur në faqen zyrtare të MSHMS-së* | |

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

*Lista e të gjitha aktiviteteve të parashikuara të konsultimit me datën e përafërt të zbatimit.*

Aktivitetet e përfshira janë:

- Shqyrtimi i aktorëve të interesit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Dërgimi i draftligjit në mënyrë elektronike me anëtarë dhe përfaqësues të institucioneve kryesore, që do të sigurojnë ofrimin e shërbimit alternativ në familje;
- Organizimi i takimeve konsultuese online ose fizikisht në ambientet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për të patur një vlerësim sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës në hartimin e ligjit të kujdesit alternativ;
- Analiza dhe përpunimi i të gjtiha komenteve të bëra nga aktorët e përfshirë;
- Hartimi i drafteve të tjera mbi bazën e përfundimeve të konsultimit me të gjitha çështjet e marra parasysh.

Këto aktivitete do të organizohen përgjatë muajit shtator 2025.

4. Burimet e nevojshme

*Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.*

| |
|---|
| Burimet njerëzore të përfshira janë anëtarët e grupit të punës për hartimin e ligjit të kujdesit alternativ dhe stafi i sektorit të shërbimeve sociale në MSHMS, shpenzimet operative janë të mbuluara nga buxheti i shtetit dhe shërbimi catering është i mbuluar nga donator- UNICEF. |

5. Mbledhja e përgjigjeve

| |
|---|
| *Përshkruani mënyrën se si mendoni që të mblidhni përgjigjet.*<br>*Përgjigjet do të mblidhen në mënyrë tabelore, ku do të përfshihet komenti i dhënë, çështja përkatëse ose përmbajtja e nenit dhe nga cili institucion/organizatë është.* |

6. Monitorimi i procesit

*Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet* ***të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiorë dhe metodave/mjeteve që do të përdorni për matjen e suksesit*** *gjatë dhe në përfundim të procesit.*

| **Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit** | | |
|---|---|---|
| **Korniza e procesit** | **Përshatshmëria** | **Masat për përmirësime** *(deklaroni, si do të përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)* |
| A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar? | ☐ po | Përcaktim me i qartë i objektivave për çdo takim konsultues. |
| A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara? | ☐ po | Planikifimi i burimeve financiare që mund të lidhen me transportin e pjesëmarrësve që do të vijnë në takimet konsultuese në ambientet e MSHMS. |
| A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara? | ☐po | Saktësismi i të gjithë pjesëmarrësve dhe konfirmimi në kohë i pjesëmmarrjes në këto takime konsultuese. |

| **Treguesit sasiorë** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Treguesit sasiorë<br>*(deklaroni treguesit për monitorim)* | Vlerat e planifikuara<br>*(deklaroni treguesit për vlerat)* | Vlerat e arritura<br>*(deklaroni vlerën e arritur)* | Përshatshmëria | Masat për përmirësime *(deklaroni si do të përmirësoni performancën)* |
| *(plotësojeni gjatë fazes së planifikimit të procesit)* | | *(plotësojeni gjatë monitorimit)* | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ☐ numri i metodave të konsultimit | 4 | 4 | ☐ po | Sigurimi që të ofrohen metoda të ndryshme për të rritur mundësinë e përfshirjes së palëve të ndryshme. |
| ☐ numri i palëve të përfshira | 15-20 | 15 | ☐ po | Sigurimi që të identifikohen palët e interesit, por jo vetëm të përfshihen edhe palë të tjera të njësive administrative në bashkitë më të vogla. |
| ☐ numri i pjesëmarrësve | 30-50 | Mesatarisht 30 | ☐ po | Sigurimi se koha, vendi, ora të jetë të përshatashme për të gjithë anëtarët mikëpritës dhe të ftuar në çdo takim konsultues. |
| ☐ numri i komenteve të pranuara | Të pranohet shumica e komenteve | Pjesa më e madhe e komenteve të dhëna | ☐ po | Sigurimi se çdo palë e përfshirë ka dhënë kontributin e tij dhe më tej do të bëhet përmbledhja e komenteve që do të pranohen. |
| ☐ tjetër: | | | ☐ po | |

| Mjetet për matjen e treguesve |
|---|
| Po- lista e pjesëmarrësve<br>Po- raportimi i aktivitetit<br>Jo- raporti i reagimeve<br>Po- lista e komenteve të marra |

<table>
<tr><td colspan="3">☐ tjetër: përmbledhje e tematikave të komenteve të dhëna</td></tr>
<tr><td colspan="3">Treguesit cilësorë</td></tr>
<tr><td>Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)</td><td>Gjetjet<br>(deklaroni gjetet)</td><td>Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)</td></tr>
<tr><td>☐ cilësia e metodave të konsultimit</td><td>Konsultimet janë realizuar me ekspertë të fushës në mbrojtjen e fëmijëve, ku janë marrë parasysh kualifikimet, përvoja e punës, iniciativat dhe angazhimi në këtë proces.</td><td>Marrja e vlerësimeve paraprake përpara takimeve konsultuese.</td></tr>
<tr><td>☐ përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve</td><td>Pjesëmarrësit kanë dhënë kontributin e tyre dhe komentet që prekin çështjet më kyesore janë pranuar.</td><td>Përpara konsultimeve do të pyeten pjesëmarrësit mbi pritshmëritë që ata kanë në këtë proces.</td></tr>
<tr><td>☐ cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara</td><td>Komentet e dërguara lidhen me çështje kryesore dhe nene specifike, ku propozimi i përfaqësuesve të institucionit/organizatës jepen të formuluara shumë qartë.</td><td>Gjatë konsultimeve do të përcaktohen pikat kryesore dhe çështjet që janë më delikate për t'u trajtuar.</td></tr>
<tr><td>☐ treguesit sipas objektivave të procesit:</td><td>Janë realizuar një sërë diskutimesh midis anëtarëve të grupit të punës si dhe efekti kohor dhe të gjtiha takimet konsultuese janë përmbushur. Është realizuar rishikimi i drafteve të projektligjit deri në versonin final të tij.</td><td>Sigurimi se objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, të rëndësishme dhe me afat kohor.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Mjetet për matjen e treguesve</td></tr>
<tr><td colspan="3">Jo- pyetësori i vlerësimit<br><br>Po- diskutimi joformal me pjesëmarrësit<br><br>Jo- regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve<br><br>Po- raportimi i aktivitetit<br><br>☐ tjetër:</td></tr>
</table>